

# RELACION

## PËR

### PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2024 – 2026”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave synon miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (në vijim PKIE) 2024 – 2026.

PKIE hartohet në zbatim të nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafruar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Pika 1 e tij përcakton “Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiket të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet”.

PKIE hartohet edhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 22.6.2022 “Për miratimin e deklaratës hapëse të Republikës së Shqipërisë, pozicioni i përgjithshëm, në kuadër të konferencës së parë ndërqeveritare për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, i cili në pjesën “Vlerësime të përgjithshme”, pika 8 përcakton se “Shqipëria pranon plotësisht objektivat e përcaktuar në nenin 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Shqipëria angazhohet për përafrimin e plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian. Shqipëria pranon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga *acquis*. Ajo do të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shteteve anëtare të BE-së”. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Procesi i negociatave të anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe i plotësimit të kushteve të hapjes, zhvillimit dhe mbylljes së negociatave.

PKIE 2024 – 2026 është plani i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin dhe standardet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet dokumenteve

strategjike e ligjore, masave institucionale e administrative dhe atyre zbatuese dhe investimeve.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024 – 2026 është hartuar bazuar në vlerësimet e raportit *screening* të grupimit të parë “Themelorëve”, publikuar nga Komisioni Evropian në 20.7.2023, si dhe në angazhimet mbi përafrimin e legjislacionit, të marra gjatë prezantimeve të palës shqiptare në takimet dypalëshe me Komisionin Evropian, për çdo kapitull dhe kriter të *acquis* dhe të propozimeve të çdo negociatori sipas kapitullit dhe/ose kriterit përkatës.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, i cili ka përcaktuar se “Evropa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale të cilës i përkasim, por ku ende mungojmë”.<sup>1</sup>

Ky projektvendim është në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, si dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian përcakton se vizioni i Republikës së Shqipërisë për periudhën 2022 – 2030 është “Shqipëria 2030”. Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj, mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut”.<sup>2</sup>

Ky vizion i qeverisë shqiptare do të arrihet edhe përmes hartimit, miratimit, zbatimit dhe monitorimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, i cili përcakton politikat, përparësitë dhe masat që synojnë përafrimin me EU *acquis*, për transformimin e gjithanshëm të Shqipërisë drejt një vendi me standarde që plotëson kriteret për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 ka një objektiv të dyfishtë. Së pari, ai do të shërbejë si instrument planifikimi i plotësimit të

---

<sup>1</sup> [https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi\\_Qeverises\\_2021-2025.pdf](https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf)

<sup>2</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88>

detyrimeve të lindura nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Kjo marrëveshje, ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”, përcakton në nenin 70 të saj detyrimin e Republikës së Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në përputhje me afatet e përcaktuara nga kjo marrëveshje.

Së dyti, PKIE 2024 – 2026 synon plotësimin e angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria në deklaratën hapëse të Republikës së Shqipërisë, pozicioni i përgjithshëm, në kuadër të konferencës së parë ndërqeveritare për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë deklaratë, Qeveria shqiptare është angazhuar si vend kandidat që ka filluar negociatat e anëtarësimit, që të përafrojë gradualisht plotësisht legjislacionin e saj me *acquis*-in e Bashkimit Evropian dhe ta zbatojë legjislacionin e përafruar si një detyrim që rrjedh nga procesi i anëtarësimit me përmbylljen e procesit *screening*, si faza e parë e negociatave të anëtarësimit.

PKIE 2024 – 2026 synon planifikimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, si një nga kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Realizimi i këtij angazhimi kërkon instrumente dhe mjete të përmirësuara për planifikimin, zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të *acquis*.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian duhet konsideruar si një cikël i vazhdueshëm, i përbërë nga këto hapa:

- Puna përgatitore;
- Analiza e mangësive;
- Planifikimi;
- Hartimi dhe kontrolli i cilësisë;
- Konsultimi dhe miratimi;
- Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi.

Për identifikimin e masave ligjore dhe të politikave, institucionale e administrative që janë përfshirë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, ministritë dhe institucionet shqiptare kanë marrë në konsideratë informacionin e paraqitur nga Komisioni Evropian gjatë takimeve shpjeguese *screening*, angazhimet e tyre të paraqitura në takimet dypalëshe, vlerësimin e Komisionit Evropian në raportin *screening* për grupkapitullin I “Themeloret”, rekomandimet e dhëna nga shërbimet e Komisionit Evropian në raportin vjetor për Shqipërinë, për vitin 2023, si dhe takimet e mekanizmave të përbashkët të ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi i paraqitur është në përputhje me:

- i. Kushtetutën dhe veçanërisht nenin 100 të saj, sipas të cilit “Këshilli i Ministrave merr vendime për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës shtetërore”;
- ii. ligjin nr.9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”, të ndryshuar, dhe veçanërisht, nenin 70 të Marrëveshjes, i cili përcakton se “Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet”;
- iii. vendimin e Këshillit të Ministrave nr.424, datë 22.6.2022 “Për miratimin e deklaratës hapëse të Republikës së Shqipërisë, pozicioni i përgjithshëm, në kuadër të konferencës së parë ndërqeveritare për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, dhe veçanërisht pikën 8 të pjesës “Vlerësime të përgjithshme”, e cila përcakton se “Shqipëria pranon plotësisht objektivat e përcaktuar në nenin 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Shqipëria angazhohet për përafrimin e plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian. Shqipëria pranon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga *acquis*. Ajo do të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shteteve anëtare të BE-së”.

Projektvendimi shfuqizon vendimin nr.122, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2023 – 2025”, duke përditësuar Planin Kombëtar për Integrimin Evropian me aktet që do të hartohen dhe miratohen gjatë periudhës 2024 – 2026.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk përafron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument planifikimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me këtë legjislacion. Projektvendimi përcakton detyrat e çdo ministrie dhe institucioni tjetër qendror për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis*-in e Bashkimit Evropian, afatet dhe shkallën e synuar të përafrimit.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Pika 1 e projektvendimit përcakton miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, si pjesë përbërëse e tij.

Pika 2 përcakton përgjegjësinë institucionale të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator për të orientuar, bashkërenduar dhe monitoruar zbatimin e PKIE-së 2024 – 2026 nga të gjitha institucionet përgjegjëse për kryesimin e secilit kapitull të *acquis*-it të BE-së, siç përcaktohet në urdhrin nr.94, datë 20.5.2019, të Kryeministrit, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”, të ndryshuar, si dhe negociatorët përgjegjës, sipas vendimit nr.422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar.

Pika 3 përcakton procedurën dhe afatet për monitorimin e zbatimit të PKIE-së 2024 – 2026. Negociatori përgjegjës për kapitullin e *acquis*-it të BE-së, i caktuar sipas parashikimeve të vendimit nr.422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, do të raportojnë rregullisht pranë ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2024 – 2026.

Në pikën 4 të projektvendimit parashikohet shfuqizimi i vendimit nr.122, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 -2025”.

Pika 5 ngarkon të gjitha institucionet, në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024 – 2026 përfshin masa ligjore dhe të politikave, masa institucionale dhe administrative, dhe masa zbatuese që shtrihen deri në vitin 2026, duke synuar përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, si dhe forcimin e kapaciteteve dhe zbatimin e tij.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian do të rishikohet në fund të vitit 2024 për të pasqyruar edhe gjetjet dhe rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian në raportet *screening* për çdo grupkapitull.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian përfshin tabelën planifikuese, ku janë të përfshira:

- masat ligjore dhe ato të politikave (dokumentet strategjike);
- masat institucionale dhe administrative;
- masat zbatuese.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen të gjitha institucionet në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 janë përcaktuar detyra të veçanta.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Nisma për ndryshimin e këtij vendimi të Këshillit të Ministrave është ndërmarrë nga ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, bazuar kjo dhe në fushën e tij të përgjegjësisë, të rregulluar me vendimin nr.517, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator”.

Të gjithë negociatorët sipas kapitullit dhe/ose kriterit përkatës, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore dhe ato të pavarura, duke përfshirë Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoritetin e Konkurrencës, etj, kanë marrë pjesë në koordinimin dhe propozimet për hartimin e këtij plani.

Projektplani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 u vendos për konsultim publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në datën 14 nëntor 2023. Periudha e konsultimit publik u mbyll në datën 15 dhjetor 2023. Në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nuk u paraqitën sugjerime nga qytetarët ose grupet e interesit.

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026”, iu dërgua për mendim të gjitha ministrive të linjës dhe Bankës së Shqipërisë, Autoriteti të Konkurrencës, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Agjencisë së Prokurimit Publik, Institutit të Statistikave, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe Departamentit të Administratës Publike.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore duke kërkuar që projektligji “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike” të parashikohet për t’u miratuar në katërmujorin e dytë të vitit 2024. Kërkesa e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është marrë parasysh dhe reflektuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian.

Ministri i Brendshëm është shprehur parimisht dakord brenda fushës së veprimtarisë shtetërore.

Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë është shprehur parimisht dakord brenda fushës së veprimtarisë shtetërore.

Agjencia e Prokurimit Publik është shprehur parimisht dakord duke sugjeruar që projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, të parashikohet për miratim në katërmujorin e dytë të vitit 2024. Po ashtu, të plotësohet “Ndryshim i kufijve monetarë” në kolonën “Fushat/aktivitetet ku synohet përafrimi”. Ky sugjerim është marrë parasysh.

APP ka sugjeruar që në lidhje me aktin “Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, tek pjesa “Fushat/aktivitetet ku synohet përafrimi” të ndryshohet përsëri duke shtuar këtë përmbajtje “Përafrimi i mëtejshëm me Direktivat e BE. Zhvillimi dhe zgjerimi në VKM i konceptit të veprimtarive ndihmëse, saktësimi i momentit të dorëzimit të kthimit të mostrave në procesin e prokurimit; etj” dhe afati i miratimit për këtë akt të përcaktohet katërmujori i dytë i vitit 2024. Edhe ky sugjerim i APP-së është marrë parasysh.

APP në lidhje me aktin “Projektvendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 25.7.2019 “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (ski)”, ka sugjeruar që titulli të ndryshohet në “Rregullore për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, tek pjesa “Fushat/aktivitetet ku synohet përafrimi” të ndryshohet përsëri duke shtuar këtë përmbajtje “Zëvendësimi i VKM-së nr. 542, datë 29.9.2021 me një VKM të re, në zbatim të ligjit të ri për sekretin shtetëror të miratuar në Mars të 2023, si dhe duke adresuar rekomandimet e ardhura nga KE sa i takon informacionit të klasifikuar”. Ky sugjerim i APP-së është marrë parasysh.

APP në lidhje me projektaktin “Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka

sugjeruar që të zëvendësohet me aktin “Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, tek pjesa “Fushat/aktivitetet ku synohet përafrimi” të ndryshohet përshtkrimi duket shtuar këtë përmbajtje “Ndryshim i kufijve monetarë në fushën e prokurimit publik të cilat sjellin afatet kohore për ankim në përputhje të plotë me afatet kohore e përcaktuara në direktivat e BE-së” dhe afati i miratimit për këtë akt të përcaktohet katërmujori i dytë i vitit 2024. Edhe ky sugjerim i APP-së është pranuar.

Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit është shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Ministri i Arsimit dhe Sportit është shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit është shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore, duke sugjeruar që në Kapitullin 27 “Mjedisi” të përfshihet projektligji “Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit”, i cili parashikohet të miratohet në katërmujorin e dytë të vitit 2024. Ky sugjerim i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është marrë parasysh.

Ministri i Kulturës ka sugjeruar që Direktiva (BE) 2014/26, Direktiva (BE) 2019/790 dhe Direktiva (BE) 2019/789 do të përafrohen përmes amendimit të Ligjit nr. 25/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, dhe se amendimi i Ligjit do të ndodhë në katërmujorin e tretë të vitit 2025. Ky sugjerim i Ministrisë së Kulturës është marrë parasysh.

Ministri i Mbrojtjes është shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është shprehur me një koment në lidhje me ndryshimin e titullit të një projektakti në Kapitullin 10 në “Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Mbi aksesin e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”. Ky sugjerim është marrë parasysh.

Ministri i Shtetit për Parlamentin është shprehur parimisht dakord dhe pa vërejtje.

Ministri i Drejtësisë është shprehur dakord me ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes së projektvendimit të Këshillit të Ministrave, duke rekomanduar që të ndryshohet titulli i projektvendimit të Këshillit të Ministrave në “Për



miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024 – 2030”. Ky rekomandim i Ministrit të Drejtësisë është marrë parasysh.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor është shprehur parimisht dakord dhe pa vërejtje.

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është shprehur parimisht dakord, duke sugjeruar që në rreshtat 149,150, 151, 152 dhe 155, te Kolona “Vlerësimi paraprak i nivelit të pritshëm të përafrimit (vetëm për masat politike dhe ligjore), togfjalëshi (e moderuar e përputhjes), të zëvendësohet me (N/A) dhe afatet për rishikimin e ligjeve nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar të ndryshojnë nga viti 2025, në vitin 2024, dhe nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshojë nga viti 2024, në vitin 2025. Këto vërejtje të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë marrë parasysh.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore, duke sugjeruar që në Kapitullin 2, përditësimi i TOC, LGA dhe IAGA të parashikohet në katërmujorin e tretë të vitit 2025, në Kapitullin 3 të parashikohet edhe projektligji “Për sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale”, në Kapitullin 7, projektligji “Për markat tregtare” dhe projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për markat tregtare” të parashikohet për miratim në katërmujorin e tretë të vitit 2024, dhe në Kapitullin 29, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 102/2014 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/20214 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, të parashikohen për miratim në katërmujorin e tretë të vitit 2025.

Të gjitha sugjerimet e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë janë marrë parasysh.

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme ka sugjeruar ndryshimin e titujve të tre akteve të parashikuara në “Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, me afat miratimi në katërmujorin e parë të vitit 2024, “Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare” me afat miratimi në katërmujorin e parë të vitit 2024, dhe “Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për përditësimin e listës së mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, me afat miratimi në katërmujorin e tretë të vitit 2024. Ky sugjerim është marrë parasysh.

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme sugjeron edhe që në relacionin shpjegues të përfshihet si referencë pika 3 e nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Pika 3 e nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nuk është përfshirë në këtë relacion. Kjo sepse pika 3 flet për fazat e procesit të përafrimit të legjislacionit gjatë një periudhe 10-vjeçare, sikurse përcaktuar në nenin 6 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kjo periudhë transitore ka filluar në momentin e hyrjes në fuqi të MSA-së më datë 1 prill 2009 dhe ka përfunduar më datë 1 prill 2019. Po ashtu, përafrimi bazohet edhe në rekomandimet e Komisionit, por asnjëherë nuk është kryer mbi bazën e një programi të dakordësuar mes Komisionit dhe Qeverisë shqiptare.

Ndërkohë në përputhje me sugjerimin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme është përfshirë në relacion referenca në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.424, datë 22.6.2022 “Për miratimin e deklaratës hapëse të Republikës së Shqipërisë, pozicioni i përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së parë ndërqeveritare për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Në përputhje me sugjerimin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, është siguruar përputhja mes projektvendimit të Këshillit të Ministrave dhe relacionit në citime dhe koncepte.

Në relacion në vend të “institucione të përfshira” është përdorur, në përputhje me sugjerimin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, koncepti “institucione në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 janë përcaktuar detyra të veçanta”.

Ndërkohë, në relacion nuk është përfshirë vlerësimi i konsultimit me tryezat e partneritetit, për shkak se këto konsultime nuk u zhvilluan nga ministritë dhe institucionet koordinuese të grupeve ndërinstitucionale për integrimin evropian.

Departamenti i Administratës Publike kërkoi përfshirjen në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026 të dy projektligjeve: projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesat në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Sugjerimi i Departamentit të Administratës Publike është marrë parasysh. Të dy projektligjet janë shtuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026 me afat miratimi në katërmujorin e tretë të vitit 2024, ashtu sikurse parashikuar edhe në Programin Analitik të Projektakteve.

Nuk paraqitën mendimet e tyre INSTAT, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Kostot për hartimin dhe zbatimin e projektakteve të parashikuara, që miratohen në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, parashikohen nga secila ministri apo institucion në buxhetin e tyre përkatës.

**MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR**

**MAJLINDA DHUKA**

Konceptoi: Altin Fuga, koordinator  
Miratoi: Elona Ajazi, drejtor  
Adrian Kamenica, drejtor Departamenti  
Ekzemplar: 2